



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**

**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti**

**Mbledhja nr. 146/2024**

**Prishtinë, më 15.10.2024, në orën 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Driton Hyseni, Gramoz Agusholli, Valentina Bunjaku – Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

**Munguan:** Abelard Tahiri, anëtar.

**Të ftuar:** z. Habib Basholli, kryesues, z. Nasuf Mjekiqi dhe z. Bahri Karaça, anëtarë të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM).

**Pjesëmarrës tjerë:** Violeta Haxholli, Eva Buqaj dhe Anitë Hakiqi, KDI; Sami Gashi, GP LVV; Festim Bytyçi, GP AAK; Erëblina Vata, Democracy+; Lulzim Kelmendi, praktikant, si dhe mediat.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj dhe Muhamet Morina.

**Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit, i zëvendësuar gjatë mbledhjes nga zëvendëskryetares e parë znj. Jeta Statovci.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 8.10.2024;**
- 3. Votimi i raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh.a. për vitin 2023;**
- 4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për lexim të dytë të Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues;**
- 5. Shqyrtimi i raporteve vjetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM, për vitet 2022, 2023 dhe këtë vit (2024);**
- 6. Të ndryshme.**

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Driton Hyseni**, tha se pika 5 e rendit të ditës, të modifikohet, sepse sot nuk shqyrtohet raporti vjetor i KPMM-së për vitin 2024, por vetëm për 2022 dhe 2023, ndërsa mund të kemi informacion për këtë vit.

**Kryetari** propozoi që raportimin e KPMM-së për punën e saj gjatë vitit 2024 deri tani, mund ta lëmë për ndonjë mbledhje tjetër.

*Rendi i ditës u miratua me ndryshimin në pikën 5 të rendit të ditës, që të hiqet raportimi për vitin 2024.*

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 8.10.2024**

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më datë 8.10.2024, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Votimi i raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh.a. për vitin 2023**

**Kryetari** theksoi se në mbledhjen e fundit është shterur debati, por në mungesë kuorumi, vendimmarrja ka mbetur për mbledhjen e radhës, andaj kërkoj sot që me votim, të deklarohemi rreth këtij raporti.

*Komisioni, me 5 (pesë) vota “për”, 1 (një) “kundër”, nxori këtë:*

### *Rekomandim*

- 1. Kuvendi të miratojë raportin vjetor të Ndërmarrjes Publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT sh.a. për vitin 2023;*
- 2. Rekomandimi i procedohet Kuvendit sipas procedurës.*

## **4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për lexim të dytë i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues**

**Kryetari** theksoi se në pajtim me nenin 76, paragrafin 9 të Rregullores së Kuvendit, ky projektligj i ka kaluar të gjitha procedurat në mes dy leximeve, andaj sot e procedojmë tutje për lexim të dytë në Kuvend.

*Komisioni, me 6 (gjashtë) vota “për”, nxori këtë:*

### *Përfundim*

*Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e tij, me amendamente, në lexim të dytë.*

## **5. Shqyrtimi i raporteve vjetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM, për vitet 2022 dhe 2023**

**Kryetari** theksoi se si Komision jemi pajtuar që bordi aktual i KPMM-së, të raportojë në Komision për vitin 2022, 2023 dhe për pjesën e këtij viti, por për pjesën e këtij viti, e hoqëm nga rendi i ditës. Bordi është prezent dhe ia japim fjalën kryesuesit të bordit, z.Habib Basholli dhe mandej hapim debat.

**Habib Basholli, kryesues i Bordit të KPMM-së**, theksoi se ne kemi menduar të raportojmë për të tri vitet, megjithatë do të vazhdojmë ashtu si keni vendosur ju. Raportin e vitit 2022, do ta paraqesë Nasuf Mjekiqi, ndërsa raportin për vitin 2023, do ta paraqet Bahri Karaça.

### ***Shqyrtimi raportit vjetor të KPMM-së për vitin 2022***

**Nasuf Mjekiqi, anëtarë i Bordit të KPMM-së**, duke paraqitur raportin, tha se KPMM, mbi bazën e kompetencës që ja jep ligji, e ka përgatitur raportin brenda afateve, por nuk ishte miratuar, sepse bordi nuk ishte funksional dhe ishte proceduar në Kuvend. Ai tutje paraqiti në formë të përmbledhur raportin e KPMM-së për vitin 2022. Në vijim, potencoi se gjatë vitit 2022 bordi kishte mbajtur 35 takime të rregullta, ku janë shqyrtuar 445 kërkesa për licenca dhe leje, ndërsa në përgjithësi, KPMM gjatë vitit 2022 ka menaxhuar me 778 licenca dhe leje. Gjatë vitit 2022, janë aprovuar 205 licenca dhe leje. Sa i përket rentës minerare, KPMM i ka realizuar sipas planifikimeve. Gjatë vitit 2022, janë realizuar 1242 inspektime në terren. KPMM, gjatë vitit 2022, ka vazhduar të bashkërendisë aktivitetet me institucionet tjera, lidhur me menaxhimin më të mirë të sektorit minerar. Realizimi i nxjerrjes së resurseve minerare në përgjithësi ka qenë shumë më i vogël sesa i planifikuar. KPMM edhe gjatë vitit 2022 është angazhuar në ndalimin e operimeve ilegale, dhe ka bërë 78 lajmërimet të veprës penale në policinë e Kosovës për personat që aktivitetin e vet e kanë zhvilluar pa licenca apo leje. Procedura përmbartimore që janë proceduar tutje, janë 97 propozime për përmbartim. Të hyrat, gjatë vitit 2022, janë mbi 31 milionë euro rreth një milion euro më shumë se ato të planifikuara.

**Armend Muja**, tha se kam disa komente rreth transparencës së KPMM-së. Raportet vjetore të agjencive duhet të publikohen në ueb faqe, ju nuk i keni të publikuara as për vitin 2022 dhe as për vitin 2023. Vendimet e bordit duhet të publikohen në ueb faqen e KPMM-së. Mbledhjet e bordit të jenë të hapura, sikurse mbledhjet e Bordit të ZRRE-së, që të jenë të përfshira edhe palët e treta. Për licencat për shfrytëzim dhe lejet për aktivitete të veçanta, a është zbatuar kriteri për leje mjedisore? Këtë përgjigje ma dërgoni me shkrim.

**Nasuf Mjekiqi, KPMM**, theksoi se tek aktivitetet e veçanta, leja mjedisore jepet për 5 vite, ndërsa avancimi i lejes është për afat më të gjatë. Këtë e kemi hasur në lëndët gjatë vitit 2022.

**Armend Muja**, tha se kohëzgjatja e licencës jepet aq sa ka rezerva. Nëse Agjencia e Pyjeve i jep pronën operatorit për 5 vjet ose AKP-ja, a duhet që edhe licenca minerare të jetë për 5 vjet? Sipas Ligjit për AKP-në, AKP-ja ka mundësi të japë pronë me qira për një vit, me mundësi vazhdimi e nuk e jep me qira për 5 vjet. Gjatë vitit 2022, a ju kanë lëshuar leje që e tejkalojnë kohëzgjatjen e qirasë së tokave nga AKP-ja? Kemi rastin në Malushgan, a mund ta trajtoni si rast

i veçantë? Të na përgjigjeni me shkrim. Bazuar në udhëzimin administrativ për leje dhe licenca, neni 10, paragrafi 6, a janë duke u zbatuar detyrimet që kanë ndërmarrjet ndaj KPMM-së? Të na dërgoni me shkrim një raport se a është zbatuar ligji për detyrimet e ndërmarrjeve lidhur me rentën minerare. A ka raste të lëshimit të licencave për zona të interesit të veçantë?

**Nasuf Mjekiqi, KPMM**, tha se ka raste të tilla.

**Armend Muja**, kërkoi që një raport për licencat në zonat e interesit të veçantë, të dërgohet me shkrim.

**Kryetari** theksoi se referuar juve, z. Mjekiqi, që thatë se ka licenca në zona të interesit, ta sqaroni a janë kompani publike apo kompani private? Na tregoni ku ka mbetur lënda në lidhje me vendimin e Kuvendit, të datës 26.10.2023, që ka të bëjë me detyrimet prej 9 milionë euro të kompanisë “Ferronikeli”? A është zbatuar vendimi i Kuvendit, që ju obligon juve që t’i jepni drejtim meritore lëndës në fjalë? Vendimi i Kuvendit ju obligon me prioritet që ta trajtoni këtë çështje, a e keni trajtuar?

**Nasuf Mjekiqi, KPMM**, tha se nuk e kemi trajtuar, sepse jemi duke shkuar me radhë. Kemi hasur në lëndë që kemi parë shumë manipulime. Tash, kur t’i vijë radha lëndës së Ferronikelit, e shqyrtojmë.

**Kryetari** pyeti: Si raporton tash Ferronikeli, a me xehe të lagur apo me të terur?

**Nasuf Mjekiqi, KPMM**, tha se Ferronikeli e ka rastin në gjykatë. Ferronikeli duhet të raportojë me xehe të lagur, edhe tash raporton me xehe të lagur.

**Kryetari**, tha se juridikisht e keni obligim për ta zbatuar vendimin e Kuvendit. Lëndën nuk mund t’i lini në pauzë, sepse krijon pasoja ekonomike. Të na dërgoni me shkrim një raport për lëndën që lidhet me Ferronikelin.

**Armend Muja**, tha se duhet ta shqyrtoni secilin vendim, duhet ta shqyrtoni rastin për Ferronikelin dhe të informoni Komisionin tonë.

**Kryetari**, tha se për periudhën e 2024, të na dërgoni një informatë, se çka keni bërë për licencat për Trepçën, për KEK-un, Ferronikelin, Sharrcemin, informacioni të na dërgohet për kohë sa më të shpejtë.

**Pal Lekaj**, theksoi se sot kemi raporte që nuk janë miratuar nga bordi dhe nuk e di si mund t’i shqyrtojmë raportet që nuk janë miratuar. Keni humbje rreth 25 milionë që kanë ndërmarrjet detyrime ndaj KPMM-së. Cilat kanë qenë veprimet e KPMM-së për operatorët që nuk iu kanë vazhduar licencat? Në raportin për 2023, në faqe 26, thuhet se janë lëshuar tri licenca të shfrytëzimit gjatë vitit 2023, dhe po ashtu, në të njëjtën faqe, thuhet se gjatë vitit 2023, KPMM nuk ka lëshuar asnjë licencë. A mund ta sqaroni këtë mospërputhje? Nuk e di çka keni bërë në vitin 2024, shpresoj se keni bërë punë të mira, por sa kemi informacione, kompanitë kanë probleme. Nëse vazhdoni si bordi i kaluar, më mirë mos të vazhdoni ju fare. Si Komision, e monitorojmë punën e juaj, aty ku shohim ngecje, do të reagojmë.

**Armend Muja**, tha se sa i përket rentës minerare të Trepçës, licencat janë të ndara sipas minierave. A i keni edhe detyrimet financiare të ndara? Sa janë detyrimet e Trepça sh.a. dhe sa ishin detyrimet e Trepçës kur ishte në AKP? Ta kemi një sqarim të saktë për detyrimet e Trepçës. Edhe një çështje, sa i përket raportimit të xehes që nxirret në veri dhe të hyrat e realizuara, dhe xehes që nxirret në jug dhe të hyrave të realizuara, aty diçka nuk po përputhet. Këtu shoh se ka anomali, dhe duhet të sqarohet. A ka mundësi që raportin për këtë çështje, ta dërgoni me shkrim? A mundeni që bashkë me AKP-në, ta e trajtoni këtë problem?

**Nasuf Mjekiqi, KPMM**, tha se borxhi i Trepçës është 22 milionë euro. Gjatë këtij mandati duhet të marrë drejtim borxhi i Trepçës.

**Habib Basholli, KPMM**, tha se ne kemi vendosur kontakte me AKP-në, dhe para ndarjes, i mbesin borxhet AKP-së, dhe pas ndarjes, i bartë Trepça sh.a. Ne i kemi vërejtur shqetësimet e deputetit Muja, dhe jemi duke e analizuar Trepçën, në tërësi.

***Kryetari, për shkak të agjendës së tij, kryesimin e mbledhjes së Komisionit ia kalon zëvendëskryetares së parë, znj. Jeta Statovci.***

**Driton Hyseni**, potencoi se duhet të shohim zbatimin e vendimit të Kuvendit nga KPMM-ja, për çështjen që lidhet me Ferronikelin.

***Kryesuesja** theksoi se debati u shterur për raportin e KPMM-së për vitin 2022 dhe potencoi që çështjet e ngritura nga deputetët, për përgjigje me shkrim, të dërgohen nga KPMM-ja për një afat të arsyeshëm. Kryesuesja, po ashtu, theksoi se presim raportet me rekomandime të Komisionit për Buxhet dhe Komisionit për Financa Publike, mandej e procedojmë në seancë rezolutën, siç parashihet me ligj dhe rregullore.*

***Shqyrtimi raportit vjetor të KPMM-së për vitin 2023***

**Kryesuesja** ia kaloi fjalën anëtarit të bordit, z. Karaça, për ta arsyetuar raportin vjetor për vitin 2023.

**Bahri Karaça, anëtar i Bordit të KPMM-së**, duke paraqitur raportin për vitin 2023, theksoi se KPMM, në bazë të kompetencës që ia jep ligji, brenda afateve ka përgatitur raportin vjetor 2023. Menaxhmenti e ka përgatitur, por nuk ka pasur bord funksional që ta miratojë dhe është proceduar me kohë në Kuvend. Viti 2023 ka qenë vit mjaft sfidues, për shkak të mosfunksionimit të bordit. Megjithatë, menaxhmenti i ka realizuar aktivitetet e planifikuara të saj dhe i ka realizuar sipas planifikimit të gjitha rentat, përveç Trepçës. Tutje, ai foli për numrin e kërkesave për leje dhe licenca, gjatë vitit 2023, menaxhimin e licencave dhe lejeve aktive, inspektimet në terren, duke përfshirë veprimet për operimet ilegale, koordinimin me inspektoratet e institucioneve tjera, shfrytëzimin e lëndëve minerale, duke potencuar se ka mospërputhje të dukshme mes planifikimit dhe realizimit, për shkak të planifikimit joreal dhe operimeve ilegale. Po ashtu, foli për taksat administrative të inkasuara, për rentën minerare, për buxhetin e KPMM-së, etj. Totali i të hyrave të planifikuara, ai potencoi se është mbi 31 milionë euro, ndërsa të realizuara mbi 27 milionë euro apo 89%. Detyrimet e përgjithshme janë rreth 40

milionë euro, ndërsa Trepça nuk i ka kryer detyrimet financiare, e që janë rreth 24 milionë euro borxhe. Sfidë ka qenë grumbullimi i shumë aplikacioneve, për shkak të mungesës së bordit.

**Driton Hyseni**, potencoi se te raporti i vitit 2022, thuhet se Ferronikeli, për vitin 2022, i ka rreth një milion detyrime, ndërsa në vitin 2023, thuhet se i ka 5 mijë euro detyrime. A mund ta sqaroni këtë çështje? Auditori i brendshëm i KPMM-së ka dalë me gjetje që Ferronikeli ka detyrime 9 milionë euro. Ju keni obligim ta trajtoni me prioritet këtë çështje dhe zbatimin e vendimit të Kuvendit. Nuk mund të ketë përjashtime Ferronikeli. Këtë çështje kemi nevojë ta sqarojmë dhe presim nga ju vendim për rastin e Ferronikelit. Pra, duhet ta kemi një informacion të qartë nga ju, për këtë çështje. A jeni marrë me këtë çështje apo fillimisht jeni marrë me aplikacionet e grumbulluara në pritje? Unë mendoj se ju, me prioritet, duhet ta shqyrtoni kalkulimin për rastin e Ferronikelit, sepse një bord është shkarkuar për këtë çështje. Në listën e detyrimeve keni rreth 37 milionë euro në vitin 2022, ndërsa në vitin 2023 rreth 8 milionë euro.

**Habib Basholli, KPMM**, theksoi se ne jemi duke i trajtuar lëndët sipas radhës. Megjithatë, mund ta prioritetizojmë dhe ta trajtojmë rastin, që ka kërkuar Kuvendi. Do të punojmë plotësisht në përputhje me ligjin. Kërkesat i trajtojmë sipas radhës, i kemi trajtuar rreth 300 kërkesa. Për kërkesat që nuk kanë qenë të plota, kemi kërkuar dokumentacion shtesë.

**Driton Hyseni**, tha se në faqen e KPMM-së, raporti vjetor i fundit është ai i vitit 2020. Ju duhet t'i publikoni raportet e juaja. Ato janë dokumente të juaja, nuk duhet të pritni miratimin në Kuvend e pastaj të publikohen.

**Habib Basholli, KPMM**, theksoi se të dhënat në ueb faqe nuk i kam shikuar, por vendimet e bordit janë në ueb faqe. E morëm sugjerimin e juaj, ato që janë për opinion do të publikohen.

**Armend Muja**, pyeti: A mund të sqaroni, se çfarë shkalle të transparencës keni për ta zbatuar, si KPMM? A mund të dimë, a po trajtohen kërkesat me kohë?

**Habib Basholli, KPMM**, potencoi se ne si bord, çdo ditë trajtojmë kërkesa, nuk është se kemi një ditë të caktuar. Nuk jemi duke shkuar me rutinën e vjetër. Çdo lëndë, çdo kompani, e trajtojmë. Ne duhet të merremi me çdo lëndë, veç e veç. Jemi duke u munduar ta bëjmë sektorin sa më mirë.

**Driton Hyseni**, theksoi se ju si bord i KPMM-së, duhet të na dërgoni një informacion për performancën për vitin 2024.

**Armend Muja**, tha se lidhur me distancat e aktiviteteve minerare nga vendbanimet apo zonat tjera që janë të parapara me ligj, neve na duhet një auditim i veçantë nga ju, për distancat ku ka aktivitet mineral.

**Pal Lekaj**, tha se për vitin 2023, keni përmendur shumë sfida, por kur jemi te rikultivimi, keni vështirësi t'i detyroni kompanitë për të rikultivuar vendin, ku është zhvilluar aktiviteti mineral. Po ashtu, keni vështirësi për inkasim të garancisë bankare. Ta sqaroni këtë? Sa i përket licencave, kur i keni dhënë, mund të jenë për 5 vite, por ka raste që nuk i janë vazhduar. Ku janë problemet? Sa i përket transparencës, ju mund të thoni se e kemi trajtuar kërkesën, por iu është

refuzuar, megjithatë duhet të sqaroni pse iu është refuzuar. Ne po shohim operatorë ilegalë të zhavorrit dhe nuk kemi informacion nga ju, sa janë të tillë.

**Habib Basholli, KPMM**, theksoi se në ditën e pestë të punës sonë, kemi filluar trajtimin e lëndëve për licenca dhe leje, si dhe i kemi njoftuar palët për plotësim dokumentacioni. Transparenca brenda KPMM-së nuk do të mungojë. Kërkesat do të trajtohen sipas ligjit. Rikultivimi bëhet me garanci bankare. Operimet ilegale janë probleme që duhet koordinuar edhe me institucione tjera. Për mospërputhjet mes ministrive dhe institucioneve tjera, kërkoj përkrahje edhe prej juve, për t'i zgjidhur këto probleme.

***Kryesuesja** theksoi se debati u shterur edhe për raportin e KPMM-së, për vitin 2023, dhe potencoi se çështjet e ngritura nga deputetët, për përgjigje me shkrim, të dërgohen nga KPMM-ja për një afat të arsyeshëm. Kryesuesja, po ashtu theksoi se presim raportet me rekomandime të Komisionit për Buxhet dhe Komisionit për Financa Publike, mandej i procedojmë në seancë rezolutat për të dy raportet, siç parashihet me ligj dhe rregullore.*

## **6. Të ndryshme**

### **Çështje vijuese**

a) **Kryesuesja** njoftoi se për javën tjetër është planifikuar ta kemi në shqyrtim raportin vjetor të ARKEP-it për vitin 2023. Mirëpo, do të njoftoheni ndërkohë për mbledhjen e radhës, sepse disa deputetë të Komisionit, do të udhëtojnë jashtë vendit, javën e ardhshme, dhe ndoshta nuk do të ketë mbledhje të Komisionit.

b) **Kryesuesja**, tha se e keni marrë një shkresë nga një zyrtarë e ZRRE-së, për disa çështje që i ka ngritur ajo. Propozoj që të kërkojmë nga ZRRE, të japë qëndrimin e tyre për çështjen në fjalë, e mandej të shohim veprimet tjera të Komisionit.

**Mbledhja përfundoi në orën 13:00.**

**E përgatiti: Staf mbështetës i Komisionit.**

**Ferat Shala,**

-----  
**Kryetar i Komisionit**